
REFORMS IN THE MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS OF THE REPUBLIC OF MACEDONIA, INTERNATIONAL SUPPORT AND THE DEVELOPMENT OF THE REFORM PROCESS

Irfan Muharemi

Ministry of Internal Affairs, Macedonia, irfan_muharemi@hotmail.com

Abstract: The issue to be addressed within this work is the reforms in the Ministry of Internal Affairs and Police of the Republic of Macedonia adopted and approved during the last decade. Reforms in the MIA and the police represent the main criterion of the country's integration into the European Union, at the same time; enable the return of citizens' confidence to the MIA and the police as well as the creation of a guarantee for the country's internal security. The vision of acceptance of European values, norms and police services in Macedonia emerged shortly after the declaration of independence of RM in the year 1991. After peaceful independence, the RM proved its commitment to the establishment and organization of efficient and accountable state institutions. In order to achieve this, the MIA should include the police, to be transformed from a state police into a service police (closer citizens). However, the most substantial efforts to reform the MIA were developed at the beginning of the new century when the state formally started the process of EU integration. As international partners, in cooperation with local authorities, were specifically engaged in creating a strategy for reform in the MIA and the police, with the aim of implementing a community policing model and instigating democratic values in the police. Direct support for this process was provided by the European Commission Mission in Justice and Ministry of Internal Affairs in Macedonia (ECJHAT). This mission was intended to assist local authorities in the creation of the Strategy for Reforms of the Most Sensitive Part of the State apparatus. Therefore, EU experts were directly involved in the task force established by the MIA with the task to prepare the Police Reform Strategy, which was approved by the Government of Macedonia in August 2003, as well as the Action Plan for its implementation adopted in December 2004. The EITC mission lasted for 18 months and ended at the end of 2003 but a new instrument EC as a policing reform supporter called the Police Reform Project (ECPRP), which was intended to provide guidance on the implementation of the reform process. Some of the standards set out in the Police Reform Strategy have been amended in accordance with the Ohrid Agreement on equal representation of all ethnic communities, in particular the representation of Albanians in the MIA. Also, the manner of electing Commanders of Police in Municipalities, where in line with the OFA, the local police leaders are elected by the municipal councils, based on lists proposed by the Ministry of Internal Affairs. Prior to the start of the reform, the MIA and the police of the Republic of Macedonia were a highly centralized organization and had to decentralize or delegate some competencies to the local government by decentralizing decision-making and accountability. In fact, this was and is difficult to achieve because it alongside the formal legal changes requires the change of thinking to officials and policemen. And this Working Group ECJHAT acknowledges that "it is easier to build an organization from beginning rather than fully reorganizing a functional organization. "

Keywords: Reform, security, strategy, implementation, decentralization, efficiency, mentality.

REFORMAT NË MINISTRINË E PUNËVE TË BRENDSHME TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË, PËKRAHJA NDËRKOMBËTARE SI DHE ZHVILLIMI I PROCESIT TË REFORMAVE

Irfan Muharemi

Minisria e Punëve të Brendshme-RM irfan_muharemi@hotmail.com

Abstrakt: Çështjen që do ta trajtojmë në kuadër të këtij punimi janë reformat në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe polici të Republikës së Maqedonisë të miratuara dhe aprovuara gjatë dhjetëvjeçarit të fundit. Reformat në MPB dhe polici, paraqesin kriterin kryesor të integritetit të vendit në Bashkimin Evropian, njëkohësisht mundësojnë kthimin e besimit të qytetarëve në MPB dhe polici si dhe krijimin e një garance për siguri të brendshme të vendit. Vizioni i pranimit të vlerave, normave dhe shërbimeve policore evropiane në Maqedoni lindi, menjëherë pas shpalljes së pavarësisë së RM-së në vitin 1991. Pas pavarësimit paqësore RM-ja, dëshmoi angazhimin e sajë për themelimin dhe organizimin e institucioneve efikase dhe të përgjegjshme shtetërore. Që të arrihej kjo, duhej që MPB përfshirë policinë, të shndërrohej nga një polici shtetërore, në një polici shërbyese (më pranë qytetarëve). Sidoqoftë,

përprojekjet më substanciale për reformimin e MPB-së u zhvilluan në fillim të shekullit të ri, kur shteti formalisht filloi procesin e integritet në BE. Ashtuqë partënerët ndërkombëtarë në bashkëpunim me autoritetet vendore në mënyrë të veçant u angazhuan në krijimin e një strategjie për reforma në MPB dhe polici, me qëllim të implementimit të modelit të policisë në komunitet, si dhe instilimin e vlerave demokratike në polici. Përkrahja e drejtpërdrejtë për këtë proces u dha nga ana e Misionit të Komisionit Evropian për Drejtësi dhe Punë të Brendshme në Maqedoni (ECJHAT). Ky mision kishte për qëllim t'i ndihmonte autoritetet vendore në krijimin e Strategjisë për reforma të pjesës më të ndjeshme të aparatit shtetëror. Andaj ekspertë e BE-së drejtpërdrejtë u përfshinë në grupin e punës të themeluar pranë MPB-së me detyrë që të përgatisin Strategjinë për reforma në polici, e cila u miratua nga ana e Qeverisë së Maqedonisë në gusht të vitit 2003, si dhe Planin e Veprimit për zbatimin e të njëjtës, të miratuar në dhjetor të vitit 2004. Misioni i ECJHAT zgjati 18 muaj dhe përfundoi në fund të vitit 2003, por filloi së funksionuari një instrument i ri i KE-së si përkrahës i reformës në polici i quajtur Projekti për Reforma në Polici (ECPRP) që kishte për qëllim të ofroj udhëzime për implementimin e procesit të reformave. Disa nga standardet e parapara në Strategjinë për reforma në polici janë ndryshuar në pajtim me Marrëveshjen e Ohrit, lidhur me përfaqësimin e barabartë të të gjitha bashkësive etnike në veçanti përfaqësimin e shqiptarëve në MPB. Gjithashtu edhe mënyrën e zgjedhjes së Komandantëve të policisë në komuna, ku në përputhshmëri me MKO-në, udhëheqësit e policisë në nivel lokal të zgjidhen nga këshillat komunal, në bazë të listave të propozuara nga MPB. Para fillimit të reformës, MPB-ja dhe policia e RM-së ishte një organizatë tejet e centralizuar dhe duhej të decentralizohej gjegjësisht të delegoj disa kompetenca te pushteti lokal duke e decentralizuar vendimmarrjen dhe llogaridhënien. Në fakt, kjo ishte dhe është vështirë të arrihet për shkak se përkrah ndryshimeve formale ligjore kërkon edhe ndryshimin e të menduarit tek zyrtarët dhe policët. Andaj Grupi Punues i ECJHAT pranon se "është më lehtë të ndërtohet një organizatë nga fillimi se sa të riorganizohet tërësisht një organizatë funksionale."

Fjalë kyçe; Reforma, siguria, strategjia, zbatimi, decentralizimi, efikasiteti, mentaliteti.

1. HYRJE

Ky punim konsiston në analizimin dhe sintetizimin e disa momenteve të rëndësishme historike të procesit të reformave, duke nisur nga pavarësimi i Republikës së Maqedonisë, marrjen e statusit "kandidat si dhe plotësimi i kriterëve të parapara për anëtarësim në Bashkimin Evropian". Për dallim nga institucionet tjera, reformat në MPB-së dhe polici konsideroheshin nga më të rëndësishmet sepse MPB dhe policia gjatë tërrë kohës akuzoheshin dhe poashtu akuzohen për sistem tepër të mbyllur të punës (mosbashkëpunim me qytetarët, veprime të dhunëshme, si dhe mosbashkëpunim me institucionet e tjera të sistemit). Të vetëdijshëm për këtë gjendje dhe sjelljen joadekuate të të punësuarëve në MPB dhe polici si dhe mungesa e mekanizmave për kontroll të punës së tyre, mundësonin që udhëheqësia e MPB-së në të kaluarën të inkurajojë dhe tolerojë veprime të dhunëshme ndaj qytetarëve. Kjo ndikoi që partnerët ndërkombëtarë përmes mekanizmave të tyre kryesisht nga donatorë të BE-së, Misionit Policor Proxima, Misionit të KE-së për Drejtësi dhe Punë të Brendshme në RM (ECJHAT), Ekipit Këshillëdhënës Policor të BE-së (EUPAT) dhe Projekti të KE-së për Reforma në Polici (ECPRP). Si dhe donatorë të tjerë, OSBE, Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore, Këshilli i Evropës³⁷⁹ dhe institucione tjera me relevancë ndërkombëtare, t'i ofrojnë ndihmë Qeverisë së Maqedonisë që ta hartoj planin aksional për krijimin dhe miratimin e strategjisë për reformimin e MPB-së dhe policisë. Ku MPB dhe policia të shëndrohen nga një polici (e mbyllur) shtetërore në një polici më e afërt me qytetarët gjegjësisht të aplikohet parimi "community policing". Ky bashkëpunim i Qeverisë së e Maqedonisë me partnerët ndërkombëtarë rezultoj me miratimin e "Strategjisë për reforma në MPB dhe polici (2003)" dhe poashtu edhe miratimin e "Planit e Veprimit për zbatimin e të njëjtës (2004)".

2. QËLLIMI I REFORMAVE, MIRATIMI I STRATEGJISË PËR REFORMA DHE LIGJIT PËR POLICINË 2006

Qëllimi themelorë i reformave, ishte përmirësimi i kualitetit në punë si garancë për siguri të brendshme që mundëson arritjen e standardeve të BE-së, dhe njëkohësisht stabilizimin e RM-së në rrugën e saj drejt integritetev Evropiane. Si parakushte themelore për zhvillimin efektiv dhe përkrahjen e reformave ishin kushtet e përgjithshme në RM, situata politike, mendimi publik, organizimi i MPB-ës dhe policisë si dhe zhvillime të tjera shoqëroro-historike³⁸⁰. Nga kjo distancë kohore dhe për nevoja të punimit do të mundohemi që në mënyrë kronologjike t'i numërojmë fazat nëpër të cilat ka kaluar dhe kalon procesi i reformave në MPB dhe polici. Ku veçojmë tri faza të

³⁷⁹ Lembovska, M. "Progresi në Evropianizimin e Sektorit të Sigurisë në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni" Prishtinë, 2013, f.60-64.

³⁸⁰ Tashevskas-Remenski, F. "Reformite vo Makedonska policija" ASHAM, Shkup, 2009, f.433.

këtij procesi, e parë (përgaditore e reformave) që e elaboruam më lartë, e dyta paraqet pjesën e miratimit të ligjeve dhe akteve tjera nënligjore si dhe faza e fundit është ajo implementimit të reformave të miratuara.

Në bazë të planit aksional për miratimin dhe implementimin e reformave dhe Strategjisë për reforma, MPB-ja merr fizionomi krejtësisht të re organizative ashtuqë, organizimi i ri ministritë e definon si trup politik, përgjegjës për zbatimin e politikave qeveritare në fushën e punëve të brendshme. Poashtu edhe përshkrimin e standardeve dhe procedurave të veprimit të policisë, mbikqyrje të përgjithshme të punës së tyre, notimin e efikasitetit dhe ekonomizimit në punë. Në përputhshmëri me Strategjinë për reforma funksionet operative të policisë, do të realizohen përmes tre shtyllave edhe atë, shërbimit policor rajonal, gjegjësisht (sektorëve për punë të brendshme numri i të cilëve zvogëlohet nga 12 në 8), qendrave regjionale kufitare si dhe shërbimeve qendrore policore. Përfundimi i këtij procesi në MPB dhe polici duhet të mundësoj, etablimin e plotë të strukturës së re organizative në ministri dhe polici, që funksionet e tyre t'i realizojnë sipas metodologjisë së re për punë dhe praktikave më të mira të policisë evropiane.

Sipas këtij procesi, parimi kyç që do të dominoj është parimi "community policing" që nënkupton bashkëpunim i thellë i policisë me popullatën e që mundëson identifikimin e përbashkët të problemeve si dhe angazhimin aktiv për tejkalimin e tyre. Reformat do të mundësojnë që policia, për herë të parë theks të veçantë të vendos mbi parandalimin, gjegjësisht mbi faktorët që shkaktojnë dhe iniciojnë sjellje kriminele. Poashtu do të kontribuoj edhe në ngritjen e vetëdijes³⁸¹ së vetë zyrtarëve policorë, për rolin e tyre në zbatimin e ligjit. Njëjtë edhe përparimi në karrierë i tyre do të varet nga rezultatet e arritura në punë, meritave të dëshmuara gjegjësisht prej parimit të profesionalizimit dhe kompetencës. Instalimi i këtij sistemi do të mundësoj përmirësimin e sigurisë së përgjithshme, vetëdijes si dhe kulturës në përgjithësi. Forma e këtillë e funksionimit do të mundësoj që objektet e policisë të përfaqësojnë vendë, ku ç' do qytetarë të mund të drejtohet për ndihmë, këshilla dhe njëkohësisht të mundet të denoncojë ngjarje. Ajo që u tha më lartë, jep mundësi që strukturat e larta udhëheqëse në MPB, më nuk do të kujdesen për punët anësore, por do të fokusohen në krijimin e politikave strategjike të zhvillimit të policisë. Koncepti i ri i organizimit do të bazohet mbi iniciativën vetanake dhe përgjegjësinë individuale të zyrtarëve të policies. Këtu janë paraparë edhe vështirësitë e këtij procesi, nga obstrukcioni i mundshëm i udhëheqësve paraprak që më parë kishin forcë në sjelljen e vendimeve, gjegjësisht mbetjen e tyre pa përgjegjësi dhe kompetenca të caktuara, dhe të njëjtët në mënyrë adekuate të delegohen në nivelet udhëheqëse, poshtë tyre. Reformat kanishin për qëllim, që ministritë dhe policinë ta vendosin në efikasitet dhe funksionalitet të plotë. Kjo nënkupton edhe rrugën e detyruar pavarësisht nga të gjithë, pasiguritë, problemet, rezistencën dhe dobësitë që duhet të kalohen, në drejtim të integritimit më të shpejtë të RM-së në familjen e madhe Evropiane. Nga ajo që elaboruam më lartë, MPB-ja definohet si organ i administratës shtetërore, fushëveprimi i së cilës është siguria e brendshme e shtetit dhe qytetarëve. Me ministritë udhëheq Ministri i zgjedhur nga Parlamenti i RM-së, kompetenca dhe fushëveprimi i ministritë përfshinë detyrat në vijim:

3. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË:

Mbrojtjen e jetës, sigurinë personale dhe pronën e qytetarëve, parandalimin e kryerjes së veprave penale, zbulimin dhe kapjen e autorëve të veprave dhe dorëzimin e tyre tek organet kompetente, mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut të garantuara me Kushtetutën e RM-së, mirëmbajtjen e rendit publik, parandalimin e urrejtjes, etnike, racore - fetare ose intolerancën, sigurimin e personave të caktuar dhe objekteve, rregullimi dhe kontrollimi i trafikut rrugor dhe aktivitete të tjera të lidhura me sigurinë e trafikut rrugor, kontrollimin i kufijëve shtetëror dhe sigurinë e tyre, qëndrimi dhe lëvizja e të huajve, si dhe shërbime në fushën e çështjeve qytetare³⁸². Në përputhshmëri me reformat dhe strategjinë për reforma në polici, struktura e re e Ministritë dhe policisë është si vijon:

4. STRUKTURA DHE ORGANE NË PËRBJE TË MPB-SË:

Kabineti i Ministrit, Zëvendës Ministr, Sekretarit të Shtetit, Sektori për Marrëdhënie me Publikun dhe Informimin Publik, për Auditim (revizion) të Brendshëm, për Bashkëpunim Ndërkombëtarë, për Bashkimin Evropian, për Kontroll të Brendshëm dhe Standarde Profesionale, për Punë Juridike dhe Kadrovike si dhe Sektori për Financa dhe materiale-teknike dhe logjistike. Organet në përbërje të ministries janë: Drejtoria për zbulim dhe kundër zbulim (DSK) dhe Byroja për siguri publike (BSP), me DSK-në dhe BSP-në udhëheqin drejtorët, të cilët me propozim të ministrit i emëron dhe i shkarkon Qeveria e RM-së. Drejtori i organit në përbërje të ministritë, është përgjegjës për punën e tij dhe punën e organit që drejton para Qeverisë dhe para Ministrit. Në sistemin e sigurisë publike punët i zhvillon BSP-ja, përmes zyrtarëve të policisë si dhe të policisë kriminale. Por për kryerjen e aktiviteteve lidhur me sigurimin dhe kundërzbulimin (aktivitetet që kanë të bëjnë me mbrojtjen nga spiunazhi, terrorizmi apo të tjera, aktivitetet

³⁸¹ Kodeksi i etikës policore („Fleta zyrtare e RM-së“), nr. 72, 11.06.2007

³⁸² Ligji për polici („Fleta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 114/06).

kërcënuese ose shkatërrimin e institucioneve demokratike të përcaktuara me Kushtetutën e RM-së me mjete të dhunshme, si dhe mbrojtje nga format e rënda të krimit të organizuar, përgjegjëse është DSK-ja³⁸³. Organet e lartpërmendura në përbërje të ministrisë, për koordinim të aktiviteteve të tyre dhe informim, komunikojnë në mënyrë të ndërsjellë. Aktivitetet e organeve i bashkon dhe i koordinon, Ministri i Punëve të Brendshme përmes drejtorëve të DSK-së dhe BSP-së.

Për kryerjen e punëve policore në territorin e RM-së formohen Sektorët e Punëve të Brendshme. SPB-të formohen në varësi nga madhësia e zonës, numrit të popullatës, numrit të veprave penale dhe kundërvajtjeje, rëndësisë së drejtimeve rrugore, gjeografisë së vendit si dhe shtrirjes së komunave që mbulohen nga SPB-të. Me SPB-ët udhëheqin kryeshëfat, Kryeshëfat e SPB-ve, i emëron dhe i shkarkon ministri nga radhët e të punësuarave në procedurë transparente. Kryeshëfati i SPB-së, përgjegjësi të drejtpërdrejt jep para drejtorit të BSP-së. Në nivel nacional SPB të tillë janë: SPB, Shkup, Manastir, Veles, Kumanovë, Ohër, Strumicë, Tetovë dhe Shtip.

Policia është pjesë e ministrisë që kryen detyra policore përmes zyrtarëve të policisë, për kryerjen e punëve policore në rajone të caktuara në SPB formohen stacionet policore të përgjegjësive së përgjithshme. Me stacionet policore udhëheqin Komandantët e stacioneve, aktivitetet e tyre i kryejnë me uniformë të policisë. Komandantët e policisë zgjidhen, nga ana e Këshillit të Komunës me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i këshilltarëve, ku është i vendosur stacioni i policisë me përgjegjësi të përgjithshme të ministrisë, nga lista që përmban më së paku tre kandidat të propozuar nga Ministri, mes të cilëve njëri nga kandidatët ti takoj bashkësisë etnike shumicë në Komunë. Në kuadër të këtij procesi, sa i përket sigurisë së kufirit shtetëror si dhe kontrollit gjatë kalimit të kufirit, për kryerjen e punëve policore formohen Qendrat Rajonale për punë kufiri: Qendra Rajonale për Punë Kufiri -Veri (me qendër në Shkup), Perëndim (me qendër në Ohër, Jug (me qendër në Kavadar) si dhe Qendra Rajonale për Punë Kufiri-Lindje (me qendër në Dellçevë).

Përveç punëve policore dhe të sigurisë në MPB kryhen edhe shërbime administrativo-qytetare të cilat MPB-ja i realizon përmes Departamentit për çështje administrative: Në përmbyllje të kësaj faze të reformave vlen të theksohet se procesi i reformave të miratuara në MPB dhe polici, rëndësi të veçantë i kushton, kontrollit të punës së policisë dhe organeve të tjera të MPB-së, që zhvillohet nga organet për kontroll edhe atë, Kontrolli i brendshëm (Sektorit për kontroll të brendshëm dhe standarde profesionale), si dhe Kontrolli i jashtëm që ushtrohet nga (Zyra e Avokatit të Popullit dhe Parlamenti i RM-së). Parlamenti i RM-së nëpërmjet Komisionit parlamentar kontrollon punën e DSK-ës. DSK-ja është e obliguar që dy herë në vit ta informoj komisionin për punën e saj, ndërsa Komisioni parlamentar për punën e DSK-ës, Parlamentin e informon çdo fund viti.

5. PRIORITETET DHE OBJEKTIVAT E MPB-SË

Për realizimin e reformave, MPB përcakton prioritetet dhe objektivat e saja, gjë që për realizimin e tyre përgatitet Plani Strategjik³⁸⁴ në kuadër të së cilit përcaktohet edhe dinamika e realizimit të tyre. Në bazë të Planit Strategjik të MPB-së prioritetet dhe objektivat janë si vijojn: Parandalim dhe zbulimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit, kthimin dhe forcimin e besimit të të gjitha komuniteteve në policinë, kompletimi i procesit të reformës policore, përmirësimin e sigurisë publike si dhe përmirësimin e efikasitetit në luftën kundër terrorizmit dhe mbrojtja e sigurisë kombëtare.

Për nevojat e punimit dhe kontributin që duhet të jep ky punim analizuar raportet vjetore të KE-së për RM-në, si dhe zhvilluar intervistë³⁸⁵ me njohës të mirë të problematikës, poashtu edhe me përgjegjës të organeve përkatëse dhe shoqërisë civile në RM gjegjësisht me, Qebir Havziun-Profesor dhe ish i punësuar në MPB, Pavle Bogoevskin nga Komiteti i Helsinkit si dhe z. Bajramovska nga Zyra e Avokatit të Popullit. Nga analiza e raporteve të KE-së dhe intervistat e zhvilluara konstatuam se, RM, nuk kishte kapacitet që ta reformoj MPB dhe policinë pa përkrahje ndërkombëtare, poashtu vërejtjet e të intrvistuarëve ishin në vijë me vërejtjet e KE³⁸⁶-së të konstatuara në Raportet vjetore gjegjësisht ngecja e zbatimit të Ligjit të policisë sidomos në pjesën e depolitizimit të zyrtarëve policorë, si dhe moszbatimi i sistemit të meritokracisë që është kushtë për rritjen e cilësisë dhe përparimit në karrierë të punësuarëve në MPB. Rekomandimet e KE-së si edhe pjesmarësëve në intervistë është se ngeçjet e konstatuara të tejkalohen të mundësohet implementimi i Ligjit dhe Akteve nënligjore, gjegjësisht procesi i reformave të vazhdojë me qëllim që të arrihen standardet e BE-së që njëherësh është edhe kërkesë e qytetarëve.

³⁸³ Po Aty

³⁸⁴ Plani strategjik i MPB-së 2008–2010, Ministria e Punëve të Brendshme, shtatorë 2007.

³⁸⁵ Muharemi, I. “Reformat në MPB dhe pilici gjatë procesit Euro-integrues të RM-së” Punim Magjistrature Tetovë. 2015 f.53-64

³⁸⁶ Komisioni Evropian, Raporti i Progresit për Maqedoninë për vitin 2006-2010.

6. KONKLUZA

Procesi i reformimit të MPB-së dhe policisë, sipas standardeve evropiane nuk ka qenë dhe sështë punë e lehtë, fakti se RM, është shtetë multietnik dhe mungesa e traditës së gjatë demokratike, politizimit të skajshëm gjegjësisht ndasive të madha shoqërore, ku edhe krahas perkrahjes së madhe ndërkombëtare procesi reformave u ballafaqua me disa sfida. Kjo nënkupton se ekspertët ndërkombëtarë mund të ofrojnë përvoja shumë të mira të vendeve të tyre, poashtu të përpilojnë dhe të hartojnë ligje dhe të propozojnë struktura të mira organizative, por barra e vërtetë mbetet mbi autoritetet vendore që t'i zbatojnë të njëjtat. Andaj vullneti politik dhe përkushtimi autoriteteve vendore nuk duhet përjashtuar, marrë parasysh faktin se MPB në të kaluarën ka patur nivel të lartë të centralizimit dhe hierarki të theksuar, ajo paraqite një organizatë që më së shumti hezitonte të ndryshojë apo të zbatojë reforma. Por bashkëpunimi i ekspertëve ndërkombëtarë me autoritetet vendore mundësoi fillimin reformave në MPB dhe krijimin e një kornize ligjore të reformave gjegjësisht përpilimin e Ligjit të policisë të miratuar në vitin 2006 nga Kuvendi Republikan dhe që filloi të zbatohet nga nëntori i vitit 2007. Nga metodologjia e aplikuar arritëm të konkludojmë se Ligji i policisë i miratuar në 2006, edhe krahas perkrahjes së madhe ndërkombëtare, arritjen e konsenzusit të gjërë politik në RM, nuk mundësoi vendosjen e vlerave demokratike dhe përvojat evropiane në funksionimin e MPB-së dhe policisë.

LITERATURA

- [1] Stojanovski, T. "Policija vo demokratsko opstestvo" Shtip: 2 Avgust C: Astor, 1997.
- [2] Tashevska-Remenski, F. "Reformite vo Makedonska policija" ASHAM, Shkup, 2009, f. 431-444.
- [3] Muharemi, I. "Reformat në MPB gjatë procesit Euro-integrues të RM-së", Punim Magjistrature, Tetovë, 2015.
- [4] Police Reform Documents, EC Police Reform Project to Former Yugoslav Republic of Macedonia, An EU funded project managed by European Agency for Reconstruction, February 2003, p. 367.
- [5] Lembovska, M. "Progresi në Evropianizimin e Sektorit të Sigurisë në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni" Prishtinë, 2013, f. 60-64.
- [6] Armstrong, Michael. "Police Corruption: An Historical Overview." New York Law School Law Review, Vol. XL, Nos. 1-2 (1995).
- [7] Ronald D. Hunter, and Jeffrey P. Rush. Police Systems and Practices: An Introduction. Englewood Cliffs, NJ: Prentice Hall Career and Technology, 1994.
- [8] Bayley, D.H. and Shearing, C.D. The New Structure of Policing: Description, Conceptualization, and Research Agenda, Washington, DC: National Institute of Justice, 2001.
- [9] Spaseski, J. Nikolloški, M. Gerasimovski, S. "Sistemi i Sigurisë së Republikës së Maqedonisë" Shkup, 2010.
- [10] Plani strategjik i MPB-së 2008–2010, Ministria e Punëve të Brendshme, shtatorë 2007.
- [11] Kodeksi i etikës policore („Fleta zyrtare e RM-së“), nr. 72, 11.06.2007).
- [12] Ligji për policinë („Fleta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 114/06).
- [13] Komisioni Evropian, Raporti i Progresit për Maqedoninë për vitin 2006-2010.
- [14] <http://www.mvr.gov.mk/>.

